



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAMI I DISIPLINËS

TEORITË E EDUKIMIT

DREJTIMI: MËSUESI

<i>Pedagogu:</i>	<i>Dr. Nada Kallçiu</i>
<i>Ngarkesa:</i>	<i>4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)</i>
<i>Frekuenca :</i>	<i>30 leksione 15 seminare</i>
<i>Lloji i lëndës:</i>	<i>E detyrueshme</i>
<i>Programi i studimit:</i>	<i>Master Mësuesi</i>
<i>Viti/Semestri:</i>	<i>I/I</i>

Shkurtesë: Në këtë cikël temash do të ndalemi mbi disa çështje që vihen në diskutim mbi edukimin, do të diskutojmë mbi gjithcka dimë mbi edukimin, që në fund të fundit do të thotë të reflektosh mbi edukimin. Duke analizuar realizimin konkret të edukimit (strukturën, përmbajtjen, metodat, zhvillimin), duke reflektuar mbi veprimtarinë e tij (qoftë edhe në mënyrë spontane dhe empirike), mbi kuptimin e kësaj veprimtarie, qëllimet dhe shkaqet e saj, do të kemi mundësi të thellohem mbi bindjet tona ekzistuese mbi atë që është edukimi dhe do të reflektojmë për rolet që mund të luajmë në përmirësimin e përvojës edukative për çdonjërin, të cilin kemi detyrën të ndihmojmë të mësojë.

Paisja e studentëve me njohuri mbi edukimin, si një nevojë e zhvillimit njerëzor, si kusht i domosdoshëm për progres dhe si mjet i përcjelljes së qëndrimeve dhe sjelljeve humane nga njëri brez tek tjetri do të jetë dhe qëllimi kryesor i këtij kursi.

Programi i studimit të lëndës synon t'u vijë në ndihmë studentëve për t'u njohur me qëllimet, objektivat dhe përmbajtjen e kursit. Gjithashtu, studentët njihen me grafikun e mësimëve të ndara për çdo javë, detyrimet që studenti ka për të shlyer gjatë gjithë periudhës së studimit, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën e nevojshme.

Tematika e leksioneve:

1. Vështrim i përgjithshëm mbi lëndën
2. Rrymat kryesore të edukimit. Lidhja dhe ndikimi i tyre në edukim.
3. Përcaktimi i teorive kyçe të edukimit, shkollat dhe filozofitë përkatëse.
4. Analizim i filozofive metafizike, dhe ndikimi i tyre në edukim.
5. Realizmi, Idealizmi, Pragmatizmi dhe Ekzistencializmi. Ndikimi i tyre në mësimdhënien postmoderniste.
6. Kompleksiteti i qëllimeve arsimore
7. Teoritë kornizuese të edukimit: Perenializmi, Esencializmi, Progresivizmi dhe Rikonstruksionizmi.
8. Shkaqet historike dhe zhvillimi i mendimit në edukim. Ndikimi i tyre në mësimdhënien postmoderniste.
9. Mendimi filozofik dhe edukativ i Russo, Montessori, Deweyt. Orientimi filozofik, qëllimi dhe mjetet e edukimit, psikologjia dhe teoria e edukimit.
10. Demokracia dhe Edukimi; vlera e lëndëve të veçanta; vlerësimi në edukimin e sotëm.

11. Teoritë postmoderne të edukimit dhe drejtësia
12. Analiza teorike në edukim. Analiza e mësimdhënies. Ndikimet postmoderne të teorive të edukimit në mësimdhënie dhe të nxënë.
13. Epistemologjia dhe edukimi. Besimi i justifikuar në të vërtetën. Fondacionalizmi, e vërteta, teoritë jo fondacionaliste të njohurive.
14. Morali dhe Etika në edukim. Etika para-iluministe, etika iluministe, utilitarianizmi.
15. Individidi dhe shoqëria në shkollë. Speciali është normal i ri

Forma e kontrollit

a. Ndjekja e leksioneve dhe e seminareve dhe pjesëmarrja aktive në to. Vlerësim për pjesëmarrjen në seminare. Kjo i jep mundësi studentit të marrë 0% deri në 5% të notës përfundimtare.

b. Memo reflektimi: Me qëllim reflektimin mbi çështjet teorike të ngritura në leksion, studentët do të shkruajnë memo reflektimi në lidhje me materialet e trajtuara në leksion, për t'u përdorur si pikë reflektimi fillestare gjatë seminareve. Studentët duhet të lidhin materialet teorike të trajtuara me përvojat jetësore si nxënës/student apo mësues. Kështu studentët do të ndihmohen të mendojnë dhe të shkruajnë teorikisht dhe të krijojnë lidhje mes ideve abstrakte dhe përvojave të përditshme edukative. Studentët do të shkruajnë 7 reflektime mbi opinionet e tyre. Pritet që reflektimet të jenë të menduara mirë dhe të organizuara qartë në format esseje prej të paktën 500 fjalëve. Secila prej tyre vlen 5% të vlerësimit, që ndikon në 0-35% të notës përfundimtare

c. Gjatë kursit studentët punojnë individualisht për realizimin e një detyre kursi, e cila duhet t'u referohet problemeve aktuale te edukimit. Ato do të jenë reflektime me trajtime historike dhe analiza krahasuese, me shembuj nga studime mbi këtë fushë, në mënyrë që studenti të sigurojë tërësinë e dijeve dhe njohurive për një kuptim të thellë të edukimit si një e tërë. Detyra e kursit ndërtohet mbi bazën e problematikave që sjellin raste tipike apo situata konkrete të marra nga realiteti ynë shkollor (parauniversitar), duke treguar dhe vlerësimin individual. Në fund të semestrit detyrat referohen. Detyrë kursi në grup mbi një nga temat që do te paracaktohet gjatë seminareve. Detyra e kursit i jep mundësi studentit te marrë 0% deri në 20% të notës përfundimtare.

d. Testimi përfundimtar. Në përfundim të kursit dhe pas shlyerjes së detyrimeve të njohura më parë, studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar me shkrim në formë testi. Provim me shkrim i detyrueshëm, do të bazohet në pyetje të hapura dhe te mbyllura mbi temat e trajtuara gjate leksioneve. Dhënia e provimit me shkrim i jep mundësi studentit të marrë 0% deri në 40% të notës përfundimtare.

Vlerësimi

<i>Pjesmarrje aktive në leksione dhe seminare:</i>	5%
<i>Memor reflektimi:</i>	35 %
<i>Detyrë kursi individuale:</i>	20 %
<i>Testimi përfundimtar:</i>	40 %
<i>Gjithsej:</i>	100 %

Literatura e detyruar

1. Frabboni, F; Pinto Minerva, F. (2003) *Manual i Pedagogjisë së përgjithshme*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, , Kapitulli 1.1 fq. 4-15, 1.2, 2.4, 3.1; 3.2; f
2. Kultura e edukimit. Jerome Bruner, Instituti i Studimeve Pedagogjike 2003
3. Noddings, N. *Philosophy of Education*, second edition, Westview Press 2007, fq. 15-27; 97-124
4. *International Encyclopedia of Teaching and Teacher Education*, Second Edition,

- Pergamon, 1995, f.290-295, 299-305.
5. Cultura della formazione, Annalisa Pavan Armando Editore 2005, f. 27-125.
 6. Costruire reti nella societa dei saperi, Francesco Russo Rubbettino 2005, f.37-42; f.75-132.
 7. Una scuola per entrare in Europa, Francesco Russo Il Mulino 2005, f.17-67 f.237-302.
 8. Orstein, A., Hunkins, P (2003). *Kurrikula: Baza, Parimet dhe problemet*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, fq. 223-247

Literatura e Rekomanduar

1. Psikologji edukimi, Wolfolk, A, CDE, 2011
2. Shkollat e të nxënit, Peter Senge, Nelda Cambron-McCabe, Timothy Lucas, Bryan Smith, Janis Dutton, Art Kleiner, Instituti i Studimeve Pedagogjike
3. Atlas i ilustruar i filozofisë, Ubaldo Nicola, Instituti i Studimeve Pedagogjike
4. Sociologjia, Anthony Giddens, Çabej 2007
5. Psikologjia individuale në shkollë dhe psikologjia e edukimit. Adler, Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve, 2005
6. Pedagogy of the Oppressed. Paulo Freire, Penguin Books 1996
7. Mësuesit, shkollat dhe shoqëria, Myra Pollack Sadker, David Miller Sadker, Eureka 1995

Miratoi

Përgjegjësi i Departamentit

Prof.Dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016